ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-26-8934-5-2-1**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i Qendres Memoriale-Kodra e Deshmoreve në Gjilan**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Archi D projekt SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Xheladin Hana Bll 9 Bregu i Diellit, Nr.6
(Adresa)

Prishtinë **10000**
(Vendi) *(Kodi postar)*

+38349131374 **N/A**
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Edona Haliti
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

archidprojekt.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

10.11.2026
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe sula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- **B05 Njoftim per Kontrat: 19.10.2026**
- **Afati për dorëzimin e tenderit: 10.11.2026 14:00**
- **Kerkese per rishqyrtim: 30.10.2026**
- **Vendimi i kerkese per rishqyrtim: 04.11.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po			**Jo**	x	

Hapja na është dërguar përmes platëformes elektronike E-Prokurimi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	x				**Jo**		

- **Kërkesa për rishqyrtim: 30.10.2026**
- **Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 04.11.2026**
- **Pavarësisht se afati i fundit për paraqitjen e ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) është data 14.11.2026, Autoriteti Kontraktues nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për vazhdimin e afatit për dorëzimin e tenderëve, duke mos marrë parasysh mundësinë e ushtrimit të së drejtës për ankesë nga ana e operatorëve ekonomikë.**

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:
- Neni 1 Qëllimi,
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve.
- Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale
- Neni 73 Dispozitat e Përgjithshme
- Neni 74 Fushëveprimi
- Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te Rregulloreve te KRPP-se.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Duke qenë të pakënaqur me Njoftimin për Kontratë të datës 19.10.2026, si dhe duke qenë se kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues, para përfundimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, ushtrojmë këtë:

ANKESË

- Më datën 30.10.2026, brenda afateve ligjore, kompania jonë ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, e cila është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues më datën 04.11.2026. Pavarësisht se afati i fundit ligjor për paraqitjen e ankesës pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) ishte data 14.11.2026, Autoriteti Kontraktues nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për vazhdimin e afatit për dorëzimin e tenderëve, duke mos marrë parasysh të drejtën ligjore të operatorëve ekonomikë për të ushtruar të drejtën e ankesës pranë OSHP-së dhe mundësinë që vendimmarrja e këtij organi të ndikojë në kushtet e procedurës së prokurimit. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 45.14 të Rregullores për Prokurimin Publik, i cili përcakton se të gjitha kërkesat për sqarime dhe përgjigjet përkatëse duhet të dokumentohen dhe të përfshihen në evidencën e dokumenteve të aktivitetit të prokurimit.

  Kjo dispozitë përcakton shprehimisht se, në rastet kur gjatë një procedure të hapur, të kufizuar apo konkurruese me negociata, ofrohen informata shtesë ose sqaruese më pak se dhjetë (10) ditë para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve,AK është i obliguar ta zgjasë afatin, në mënyrë që operatorëve ekonomikë t'u sigurohen së paku dhjetë (10) ditë për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave, përmes përgatitjes dhe publikimit të Njoftimit për Korrigjim. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues është dashur të sigurojë respektimin e afateve dhe të drejtave procedurale të operatorëve ekonomikë, duke mos vazhduar procedurën në mënyrë që mund të cenojë ushtrimin efektiv të së drejtës për ankesë dhe parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë.

- Autoriteti Kontraktues per kerkesen: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2-

Kërkesa 3. OE duhet te ofroj deshmi per produktet e ofruara, produktet e betonit të përdorura në realizimin e punimeve, përfshirë kubëzat e betonit dhe elementet skajore, duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet e aplikueshme për produktet përkatëse. 3. Për produktet e parapara në paramasë, ofertuesi duhet të dëshmojë përputhshmërinë e tyre me kërkesat teknike përkatëse, përmes dokumentacionit teknik të prodhuesit dhe, aty ku kërkohet sipas legjislacionit dhe standardit përkatës, shënimit CE dhe Deklaratës së Performancës (DoP), në përputhje me Rregulloren (EU) Nr. 305 2011. Nëse ofertuesi nuk posedon certifikimin përkatës, lejohet lidhja e marrëveshjes me një prodhues ose furnizues të autorizuar që posedon certifikimin përkatës. Marrëveshja duhet të jetë e vlefshme për këtë projekt dhe për të gjithë periudhën e zbatimit të tij.

Lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues që operatorët ekonomikë të dëshmojnë përputhshmërinë e produkteve të betonit, përfshirë kubëzat e betonit dhe elementet skajore, përmes dokumentacionit teknik të prodhuesit, shënimit CE, Deklaratës së Performancës (DoP), certifikimeve përkatëse, si dhe posedimit të marrëveshjeve me prodhues apo furnizues të autorizuar, konsiderojmë se kjo kërkesë, në formën dhe mënyrën e përcaktuar, është e panevojshme, joproporcionale dhe potencialisht kufizuese për konkurrencën. Kjo për arsye se Autoriteti Kontraktues, përmes përcaktimit të kërkesave kaq specifike për dokumentacionin dhe karakteristikat teknike të produkteve, ka krijuar kushte që në praktikë mund të përmbushen vetëm nga një operatorë ekonomikë. Madje, bazuar në një hulumtim të thjeshtë të tregut, përfshirë publikimet në rrjetet sociale (Facebook), mund të identifikohet prodhuesi i produkteve të tilla, i cili së fundmi ka siguruar certifikimet përkatëse. Për këtë fakt, si dëshmi shtesë, nga i cili mund të vërtetohet se kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit përputhen me dokumentacionin dhe produktet që posedon ky prodhues, dhe askush tjetër në vendin tonë nuk posedonë. Në veçanti, kubëzat e betonit me dimensionet e përcaktuara në paramasë dhe parallogari, si dhe elementet skajore me specifikimet e kërkuara, janë produkte që, sipas hulumtimit tonë të tregut, aktualisht i posedon vetëm një operator ekonomik/prodhues. Rrjedhimisht, përcaktimi i këtyre kërkesave në këtë mënyrë krijon një avantazh të dukshëm për operatorët ekonomikë që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta me këtë prodhues. Sa i përket përgjigjes së Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, ku është theksuar se operatorëve ekonomikë u është mundësuar lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me prodhues apo furnizues të autorizuar, sqarojmë se kjo mundësi është vetëm formale dhe nuk garanton konkurrencë reale. Në praktikë, marrëveshje të tilla nuk mund të sigurohen nga të gjithë operatorët ekonomikë, veçanërisht kur dokumentacioni dhe certifikimet për produktet specifike kërkohen nga një numër i kufizuar prodhuesish, e që është vetëm një. Për më tepër, kur këto produkte dhe certifikime i posedon vetëm një prodhues ose një numër tejet i kufizuar prodhuesish, mundësia për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit nuk e eliminon karakterin kufizues të kriterit. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se edhe vetë Autoriteti Kontraktues është në dijeni të kompanisë prodhuese që operon në Gjilan dhe që posedon certifikimet përkatëse për këto produkte. Duke marrë parasysh specifikimet teknike të materialeve të kërkuara, dimensionet e përcaktuara dhe dokumentacionin e kërkuar, ekzistojnë arsye të bazuara për të konsideruar se kriteri është hartuar në përputhje me karakteristikat dhe dokumentacionin që posedon një prodhues i caktuar, duke krijuar kështu avantazh për operatorët ekonomikë që kanë marrëdhënie kontraktuale me të. Theksojmë se operatorët ekonomikë duhet të kenë mundësi të ofrojnë produkte alternative, me kusht që ato të përmbushin kërkesat e cilësisë, performancës dhe karakteristikave teknike të përcaktuara në projekt dhe në paramasë e parallogari. Përputhshmëria teknike e një produkti nuk duhet të kufizohet vetëm në dokumentacionin apo certifikimet CE, dhe Deklaratës së Performancës (DoP), që posedon një prodhues i caktuar, por duhet të mundësohet edhe dëshmimi i produkteve ekuivalente, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për më tepër, kërkesat e tilla nuk duhet të shërbejnë si mekanizëm për kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, por duhet të jenë të arsyetuara, proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, duke respektuar parimet e konkurrencës së drejtë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Rrjedhimisht, kërkojmë nga ana e Ekspertit Shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues që ta rishikojë këtë kërkesë dhe ta ndryshojë formulimin e saj, duke eliminuar kushtet që favorizojnë një prodhues të caktuar dhe duke e larguar këtë kriter diskriminues.

- **5. Lista e stafit te OE,personeli i kualifikuar, se paku (10) punëtor ne mesataren e te punësuarve ne tri vitet e**

fundit, ku disa prej tyre të jenë personel i kualifikuar me pesë vite përvojë pune pas diplomimit një Ndërtimtar, një Arkitekt,një Makinerist, një Elektricistë,nje Hidro Instalues. 5. Listën e punëtorëve të operatorit ekonomik, e njëjta duhet të dorëzohet origjinal. Kontratat ose para kontratat mbi marrëdhënien e punës të minimum 10 punëtorëve, të cilet duhet te jene te trajnuar në siguri dhe shëndet në punë, listën e projekteve të evidentuar dhe nënshkruar. Për personelin e kualifikuar duhet të prezantohen diplomat kopje të shkollave profesionale të akredituara nga institucionet shtetërore.

Në lidhje me kriterin për personelin, Autoriteti Kontraktues fillimisht kërkon që operatori ekonomik të dëshmojë se ka pasur së paku 10 punëtorë në mesataren e të punësuarve gjatë tri viteve të fundit, përfshirë personelin e kualifikuar në profilet përkatëse profesionale. Ndërsa, në pjesën e dëshmive të kërkuara, përcaktohet se operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratat ose parakontratat mbi marrëdhënien e punës për së paku 10 punëtorë. Konsiderojmë se kjo kërkesë është e paqartë dhe kontradiktore, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar qartë nëse personeli duhet të jetë i punësuar paraprakisht në kuadër të operatorit ekonomik, apo nëse lejohet që për realizimin e projektit të angazhohet përmes kontratave të reja ose parakontratave. Autoriteti Kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë ndërmjet këtyre dy kërkesave dhe të specifikojë se çfarë dokumentacioni pranohet për secilën prej tyre. Për këtë arsye, kërkojmë që AK të sqarojë shprehimisht: A duhet që 10 punëtorët të jenë të punësuar me kontrata të rregullta pune në momentin e dorëzimit të ofertës? Apo lejohet që operatori ekonomik të paraqesë kontrata paraprake (parakontrata) për angazhimin e tyre në rast të shpërblimit me kontratë? Rrjedhimisht, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta qartësojë kriterin dhe të lejojë dëshmimin e angazhimit të personelit përmes parakontratave.

- Në lidhje me kërkesën për listën e pajisjeve sipas Aneksit 7, konsiderojmë se një pjesë e specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues janë tepër të detajuara, kufizuese dhe nuk dëshmojnë domosdoshmërisht nevojën reale për realizimin e punimeve. Sipas parimeve të Ligjit për Prokurimin Publik, kriteret dhe specifikimet teknike duhet të jenë të përcaktuara në mënyrë të qartë, objektive, proporcionale dhe në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, pa krijuar pengesa të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe pa favorizuar pajisje apo konfigurime të caktuara teknike.

3.1. Kamion kiper me peshë maksimale të ngarkesës së lejuar 20–24 ton – 3 copë

Përcaktimi i kapacitetit të kamionëve me peshë maksimale të ngarkesës së lejuar me intervalin 20 deri në 24 tonë është i panevojshëm dhe kufizues, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar pse pajisja duhet domosdoshmërisht të ketë kapacitet brenda këtij intervali të ngushtë. Nëse ekziston nevoja për një kapacitet të caktuar transportues, AK duhet të përcaktojë një prag minimal ose maksimal të arsyetuar teknikisht, dhe jo një interval të tillë që përjashton automatikisht pajisjet me kapacitet më të lartë ose më të ulët, të cilat mund të jenë plotësisht të përshtatshme për realizimin e punimeve. Pretendimi yne ngritet duke e analizuar paramasen dhe parallogarinë e që nuk paraqitet nevoja për një paisje me peshë kaq specifike. Andaj kërkojmë nga ana juaj që të obligohet AK, që të paraqes një kufi minimal, apo maksimal të peshës së ngarkesës për paisje.

3.2. Grejder nivelizues digjital, minimum 10 ton

Kërkesa që grejderi të jetë i pajisur patjetër me sistem nivelizimi digjital është e panevojshme dhe favorizuese, pasi ky sistem përfaqëson një pajisje shtesë teknologjike dhe nuk është domosdoshmërisht kusht për realizimin e punimeve të nivelizimit. Punimet mund të realizohen në mënyrë profesionale dhe në përputhje me projektin edhe përmes grejderëve standardë, këtë konstatim e kemi pasi që kompania jonë ka përfunduar punime të ngjajshme dhe nivelizuesi digjital nuk është një kërkesë e nevojshme siq është specifikuar nga ana e Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar se përse është i domosdoshëm pikërisht sistemi digjital, edhe pse ne kemi kërkuar informata shtesë për paisjen, nëse kjo mund të dëshmohet me atest, ndërsa autoriteti nuk ka pranuar e gjitha është bërë për të krijuar kështu një kufizim të panevojshëm për operatorët ekonomikë që posedojnë grejderë me karakteristika dhe kapacitete të përshtatshme. Kërkojmë nga ana juaj si Ekspert Shqyrtues dhe Panel Shqyrtues që kërkesa për nivelizim digjital të largohet dhe të lejohet përdorimi i grejderëve standardë me kapacitetin e kërkuar.

3.3. Buldozer 12–16 ton

Përcaktimi i kapacitetit të buldozerit në intervalin 12–16 tonë është një kufizim i panevojshëm teknik. Nuk është e arsyeshme që pajisjet të kufizohen në një interval të ngushtë, pa një arsyetim konkret lidhur me nevojat teknike të projektit. Autoriteti Kontraktues duhet të përcaktojë një kapacitet prag minimal ose maksimal, varësisht nga nevoja reale e punimeve, dhe jo një interval të mbyllur që mund të përjashtojë pajisje të tjera të përshtatshme. Kërkojmë që ky specifikim të riformulohet duke përcaktuar vetëm një prag të qartë të kapacitetit, të arsyetuar sipas natyrës së punimeve. Kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe të obligohet Autoriteti Kontraktues që të bëjë plotësimin, korrigjimin dhe ndryshimin e kërkesave të kundërshtuara, në mënyrë që ato të jenë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores përkatëse, duke garantuar transparencën, konkurrencën e drejtë dhe trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.

3.4. Cilindër me xhemba me telekomandë deri në 1 ton

Kërkesa që cilindri me xhemba të jetë patjetër i pajisur me telekomandë është e panevojshme dhe nuk përbën domosdoshmëri teknike për realizimin e punimeve. Telekomanda paraqet vetëm një mënyrë shtesë të operimit të pajisjes dhe nuk ndikon domosdoshmërisht në aftësinë e saj për të realizuar ngjeshjen e materialit sipas kërkesave teknike. Telekomanda nuk është element esencial per realizimin teknik te kontrates, pasi që edhe një cilindër me xhemba me një peshë deri në 1 tonë edhe pa telekomandë mund të kryej po të njëjtin funksion. Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar se përse është i domosdoshëm, edhe pse ne kemi kërkuar informata shtesë për paisjen, nëse kjo mund të dëshmohet me atest, ndërsa autoriteti nuk ka pranuar e gjitha është bërë për të krijuar kështu një kufizim të panevojshëm për operatorët ekonomikë që posedojnë grejderë me karakteristika dhe kapacitete të përshtatshme. Për këtë arsye, kërkojmë që të largohet kushti për posedimin e telekomandës dhe të lejohet përdorimi i cilindrave me xhemba që përmbushin funksionin dhe kapacitetin e kërkuar teknik. Kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe të obligohet Autoriteti Kontraktues që të bëjë plotësimin, korrigjimin dhe ndryshimin e kërkesave të kundërshtuara, në mënyrë që ato të jenë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores përkatëse, duke garantuar transparencën, konkurrencën e drejtë dhe trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.

3.5. Kamion kiper me kran dhe platformë (kosh teleskopik 15 m), me peshë bartëse deri në 7 ton

Përcaktimi i peshës bartëse në formën “deri në 7 ton” është kufizues dhe nuk është i arsyetuar nga pikëpamja teknike, pasi vendos një kufi maksimal që mund të përjashtojë kamionë me kapacitet më të lartë bartës, ndonëse këta mund të jenë plotësisht të përshtatshëm për realizimin e punimeve. Koshi teleskopik dhe **vetem 15meter** dhe mos lejimi i gjatesise min, apo max, por specifikimi vetem 15metër është një kriter direkt diskriminues/favorizues. Gjithashtu, kërkojmë që AK të arsyetojë domosdoshmërinë e kombinimit të të gjitha këtyre specifikimeve në një pajisje të vetme, përkatësisht kamionit kiper, kranit, platformës dhe koshit teleskopik me lartësi 15 metra. Kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe të obligohet Autoriteti Kontraktues që të bëjë plotësimin, korrigjimin dhe ndryshimin e kërkesave të kundërshtuara, në mënyrë që ato të jenë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores përkatëse, duke garantuar transparencën, konkurrencën e drejtë dhe trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.

3.6. Eskavator (makineri me strukturë rrotulluese), i pajisur me sistem nivelizimi digjital, 3.5–6 ton

Edhe në këtë rast, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar një interval të ngushtë të kapacitetit prej 3.5 deri në 6 tonë, duke e kombinuar atë me kërkesën shtesë për sistemin e nivelizimit digjital.

Kjo kërkesë është e tepërt dhe kufizuese, pasi nuk është paraqitur asnjë arsyetim teknik se përse eskavatori duhet të ketë patjetër këtë interval të saktë të peshës dhe, njëkohësisht, sistem nivelizimi digjital. Eskavatorët standardë me kapacitete të përshtatshme mund t'i realizojnë punimet e parapara pa pasur nevojë për pajisje të tilla shtesë teknologjike. Sistemi per nivelizim digjital nuk është element esencial per realzimin teknik te kontrates. Për më tepër, kombinimi i intervalit të ngushtë të peshës me një teknologji specifike të nivelizimit digjital e ngushton edhe më tej numrin e pajisjeve që mund të plotësojnë këtë kriter.Kërkojmë që të largohet detyrimi për sistemin e nivelizimit digjital dhe që kapaciteti i eskavatorit të përcaktohet përmes një kriteri objektiv, minimal ose maksimal, në përputhje me nevojat reale të projektit. Kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe të obligohet Autoriteti Kontraktues që të bëjë plotësimin, korrigjimin dhe ndryshimin e kërkesave të kundërshtuara, në mënyrë që ato të jenë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores përkatëse, duke garantuar transparencën, konkurrencën e drejtë dhe trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.

Duke u bazuar në të gjitha sa u cekën më lart, konsiderojmë se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues nuk janë të arsyetuara në raport me natyrën e punimeve, ndërsa disa prej tyre krijojnë kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe mund të ndikojnë drejtpërdrejt në kufizimin e konkurrencës.

Në këtë drejtim, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të bëjë një rishikim të plotë të kërkesave të lartcekura, duke i përshtatur ato me parimet e konkurrencës së drejtë, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit.

Në bazë të pretendimeve të ngritura nga ana e AK-së janë shkelur një mori dispozitash ligjore të ndara, të lidhura dhe të varura me njëra tjetrën, që i kanë kushtuar rëndësi të veçantë parimeve dhe mënyrës së përcaktimit të kritereve/kërkesave minimale për kualifikim për t'i mundësuar AK që të verifikojë se OE i posedon aftësitë e nevojshme kualifikuese nga neni 65-70 të këtij ligji, duke i kufizuar që të jenë: relevante/nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, që nuk mund të kenë peshë të caktuara, që nuk kufizojnë konkurrencën në mes OE, dhe që nuk janë diskriminuese kundër ose në favor të një ose më shumë OE. Nëse Autoriteti Kontraktues ka nevojë për një kapacitet të caktuar bartës, duhet të përcaktojë kapacitetin minimal të nevojshëm, duke lejuar edhe pajisjet me kapacitet më të lartë. Njëkohësisht, këto kritere duhet të jenë relevante, të domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, të mos vendosin kufizime të pajustifikuara, të mos pengojnë konkurrencën ndërmjet OE-ve dhe të mos përmbajnë elemente diskriminuese, qoftë në favor apo në dëm të një ose më shumë Operatorëve Ekonomikë. Në këtë mënyrë, nga ana e Autoritetit Kontraktues (AK) janë shkelur një sërë dispozitash ligjore, të ndërlidhura dhe të ndërvarura me njëra-tjetrën, të cilat i kushtojnë rëndësi të veçantë parimeve dhe mënyrës së përcaktimit të kritereve dhe kërkesave minimale të kualifikimit. Këto dispozita përcaktojnë se kriteret e vendosura nga AK duhet të shërbejnë ekskluzivisht për të verifikuar nëse Operatorët Ekonomikë (OE) i posedojnë aftësitë e nevojshme kualifikuese, në përputhje me nenet 65–70 të LPP-së. Mirëpo, siç dëshmohet nga rrethanat faktike dhe ligjore, rezulton se nga ana e AKsë shkilen në mënyrë flagrante/arbifrare detyrimet ligjore, sepse kriteret e përzgjedhjes të vendosura në këtë aktivitet janë bazua në konsideratë tjera e jo në parimet bazike dhe kërkesat ligjore të prokurimit publik nga nenet 1, 7, 51 të LPPsë; 17.17 dhe 25.4 të RRPP Nr.001/2023, nenit 8 ROUPP 001/2023. Në të kundërtën, ruajtja e këtyre kërkesave pa një arsyetim objektiv dhe teknik do të krijonte dyshime serioze për kufizim të konkurrencës dhe favorizim të operatorëve ekonomikë të caktuar, në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Paragrafi 1 i nenit 7-të LPP-së e parasheh qartas qe Autoriteti Kontraktues do ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, Poashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së një aktivieti të prokurimit të gjitha autoritet kontraktuese do të sigurojnë që (vi) që tenderi i zgjedhur të pëeputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse mirepo AK-ja nu ki është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ana juaj si OSHP që të merr:

V E N D I M

- **APROVOHET** si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik.: **Archi D projekt SH.P.K**
- **URDHËROHET:** Autoriteti Kontraktues që të bëjë ndryshimin dhe përmirësimin e kërkesave të kundërshtuara në këtë ankesë, duke i harmonizuar ato me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionit sekondar në fuqi, në mënyrë që kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit të jenë objektive, të arsyeshme, proporcionale me natyrën dhe qëllimin e kontratës dhe të mos përmbajnë kritere diskriminuese apo kufizuese të konkurrencës.

Gjithashtu, URDHËROHET që pas eliminimit të kritereve diskriminuese dhe përmirësimit të dokumentacionit të tenderit, Autoriteti Kontraktues të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Duke pasur parasysh shkeljet e evidentuara më sipër nga ana e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se veprimet e tij na kanë shkaktuar dëme materiale dhe shpenzime të panevojshme lidhur me përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim, si dhe të kësaj ankese, si pasojë e vendosjes së kritereve diskriminuese, joproporcionale dhe të paarsyeshme, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe qëllimin e kontratës.
Rrjedhimisht, konsiderojmë se përmes këtyre kërkesave kufizuese po cenohet drejtpërdrejt e drejta jonë për konkurrim të drejtë dhe të barabartë, si dhe po kufizohet konkurrenca e lirë në këtë procedurë të prokurimit.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"